



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Изборни Панел за Жалбе и Представке

ZL.Anr.793/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me apelin e Kastriot Kastrati nga Departamenti Ligjor, nga radhët e subjektit politik LVV, me seli në Prishtinë, dega në Gllogoc, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 11.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e pa rregullt apeli i parashtruar nga Kastriot Kastrati nga Departamenti Ligjor, nga radhët e subjektit politik LVV, me seli në Prishtinë, dega në Gllogoc, me numër ZL.Anr.793/2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017,

A r s y e t i m

Me datën 09.11.2017, PZAP-i ka pranuar një apel nga Kastriot Kastrati nga Departamenti Ligjor, nga radhët e subjektit politik LVV, me të cilën thekson se KQZ me rastin e shpalljes së rezultateve përfundimtare të kandidatëve, të cilat (disa prej tyre) rezultojnë të jenë të korrigjuara dhe të manipuluar. Më tej kërkon që të rinumërohen votat në këto vendvotime: 0306e/02r, 0306e/04d, 0322e/01r, 0322e/02d, 0323e/01r, 0323e/02d, 0309e/03d, 0309e/01r, 0325e/01r, 0325e/02d, 0320e/02d, 0301x/01r, 0311e/03d, 0311e/07r, 0313e/03d, 0313e/02r, 0307e/02d, 0311e/02r, 0307e/02d, 0321e/01r, 0301x/04d, 0301e/03r, 0301e/04r, 0301/02, 0304e/01r, 0304e/02r, 0321e/02d, 0320e/01r.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të rregullsisë së ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pa rregullt

PZAP-i, nga shkresat e lëndës vlerësoj se apeli i **Ekipi hetimor i përbërë nga:**

1. Adnan Konushevci, Hetues kryesor,
2. Kudret Hasani, Hetues - Asistent,
3. Fitore Isufi, Asistent

parashtruar nga ana e Kastriot Kastratit, nga radhët e LVV-së, me seli në Prishtinë, dega në Gllogoc, është e parregullt, sepse nuk është e nënshkruar nga Kastriot Kastrati dhe si e tillë ankesa nuk i plotëson kriteret e Rregullës Nr.02/2015 të nenit 5.6, ku përcaktohet se:

Ankesat duhet të dorëzohen me shkrim dhe duhet të jenë të nënshkruara nga ankuesi apo në emër të tij nga i autorizuari.

Prandaj PZAP-i, nuk u lëshua fare në meritat e ankesës, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozitat e lartëtheksuara.

Nga arsyet e sipërshënuar e në mbështetje të nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL. Anr.796/2017 më datën 11.11.2017.



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.